




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primitjeto Me Dated 20-11-2024			
Nr. I organizat	Datum i primitje	Mbrojtja e primitje	Vlera Vrednost
01 - 060	01-1115		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershori, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **XI** të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **27.11.2024 (e Merkurë), në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit Komunal.**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme përvitit 2025.**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit.**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik.**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm ngastrën kadastrale në zonën kadastrale të Vërban.**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratim të dy anëtarëve të komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve përinstitucionet edukativo arsimore të nivelit, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunën e Vitisë.**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim dhe plotësimin e rregullores përtaksa, ngarkesa dhe gjoba me nr. 01-110/05-1151, e datë 30.09.2024.**
- Informatë nga Drejtoria për Bujqësi për planin operativ përmbylljet vjeshtore përvitin 2024-2025.**

Viti, më 20.11.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË DHJETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 31.10.2024 (e ejte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ali Bajrami, z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ilir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Majlinda Shabani, z.Taulant Haxhiu, z.Musli Neziri, z.Veton Ramadani, znj.Zyrafete Rama, ndërsa mungoi z.Sokol Shaqiri, z.Sokol Hyseni, znj.Marigona Avdiu, znj.Lindita Demelezi, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Anisë Zejnallahu, z.Reshat Azizi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtoreve, zyrat e kryetarit, mediat elektronike, OSBE-ja dhe të tjerë.

Pasi u konstatua se prezent janë 20 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, përfaqësues të OSBE-së, mirë se keni ardhur në mbledhjen e dhjetë për këtë vit të Kuvendit. Gjatë kësaj periudhe shumica e akteve janë kthy në përputhje me ligjin. Para se me kalu në rend të ditës hapi debatin për pyetjet dhe përgjigje duke ju kërku që të ju përbahemi kohës.

z.Jakup Demiri: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Këtu prej ekzekutivit nuk e di kush është nënkyetari, nuk qenka që zakonisht është arsyet, nuk i di, unë kam pyetje edhe për nënkyetarin që po e përsërissë, prapë më janë anku disa qytetarë te këto ndërtimet që janë bërë ata që i kanë pas bizneset, por është dhe një ndërtues ilegal, i cili ai veç se e ka finalizu aty dhe nuk e di a i ka kry komuna apo inpeksionit procedurat e veta rreth asaj problematike. Dhe një pyetje për një trotuar në Pozheran që lidhë rrugën Pozheran-Qifllak-Tërpezë, para 2 vite është fillu ajo dhe është ndërpresa. Ka probleme me prona private, por ana e kundër ka hapësirë bollë për me ndertu trotuarin, por e kanë bërë në anën e kundërt që edhe ka shpija më pak dhe që nuk levizin shumë fëmijët atypari, por ajo është nderpre, por pse është nderpre, pse nuk vazhdon. Kam dhe një pyetje, pagesat a janë bërë përmes përbartuesit, vendimeve gjyqësore apo në gjendje të rregullt për shpronësimin e një parcele të Agron Ahmetit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Te kjo çështja e pagesave të vendimeve të gjykatave, kisha kërku prej drejtorisë që me na sjellë një informatë në seancen e ardhshme për të gjitha pagesat që janë bërë për këtë vit.

z.Ilir Zuka: Përshendetje të nderuar të pranishem! Desha të ju njoftoj që nënkyetari është në pushim vjetor, kryetari ishte duke ardhë, por ka një takim me Komunën e Gostivarit, besoj që pas përfundimit do të na bashkangjitet. Një ndimes Jakupit për në Pozheran. Qe dy ditë ka fillu trotuari, për shkak që kemi pas problem me një pronë publike. Trotuari është te lagjja “Pira” që lidhë çerdhen dhe fshatin Terpezë. Një pyejte për drejtorin e rinisë, sportit dhe kulutrës. Drejtor, deri ku kanë mbrri punimet te salla e sporteve, se isha në vizitë dhe si e pash, ende pa përfudnu një pjesë mbrapa veç kish fillu me u prishë. Kryesues, ndoshta mundesh me na dhanë një përgjigje: çka është ka ndodhë me autostraden? E dijë që këtë shqetësim e ka ngritë edhe Sejdi Emini, që ka kërku, në qoftë se nuk bëhet autostrada jena në gjendje me blloku rrugën veç me u bë kyqja e Vitisë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne mund të japid përgjigje, atë çka jemi kompetent, ndërsa për tjerat veç mundemi me diskutu, sepse përgjigjen nëse e kërkojmë duhet prej ministrisë me ja bë një shkresë dhe si ku vend dhe drejtore përkatëse që me marrë një përgjigje zyrtare prej ministrisë, sepse ata e kanë informatën.

z.Taulant Haxhiu: Përhendetje të nderuar të pranishem! Unë nuk po e di çka mundemi me diskutu ne, kur kryetari dhe nënkyetari nuk është këtu, se nuk janë njerëzit komponent që i ndëgjojnë kërkesat tona. Mua nuk më intereson a është ai në takim apo ky tjetri në pushim, seancat e ku vendit janë 1 herë në muaj dhe duhet me qenë ekzekutivi këtu. Këta janë drejtore dhe mundën me na dhanë përgjigje për sektorët e vet, por jo përgjigje që janë kogja interesante për ta dhe për qytetarin e Komunës së Vitisë. Desha të lidhem te kjo rruga te sheshi. Unë po e shof që kjo rruga me kallderm që u shtru, janë dhanë 300 mijë euro. Kjo më shumë është bërë me blloku qytetin, kaloj tectori po shkon nëntori, po vjen dhjetori, tash u blloku dhe kjo. Beso që qytetarët e Vitisë nuk po dinë ku me i lanë veturat, e ka blloku të gjithë qytetin. Unë nuk e di çka po donë me bë me të. Tash vjen dhjetori, kemi dhe një sezoni tjetër, Vitia është blloku e tëra, nuk e di çka u bë me këto punë, i bënë shkel e shko punët pa asnje projekt, pa i kry senet, veç hajt ta prishi, ta ndreqi. Kjo është bërë vetëm në Kore të Veriut dhe në Viti bëhet. Drejtore, kam një shqetësim, e kam ngritë shpesh në këtë ku vend për rrugën "Hasan Prishtina", është një rrugë shumë e banushme në Komunën e Vitisë, ku unë jam pjesë e asaj lagje. Duhet patjetër me pas një polic të shtrirë, për shkak se aty lëvizin kerret shumë shpejtë, ka shumë fëmij, banrë. Një ditë veç ka qenë një aksident, një veturë ka hy brenda në kafiteri, sepse levizja e veturave është shumë e shpejtë. Po shof që po shtrohen rrugë në Stanqiq e Goden. Qyteti i Vitisë ka shumë banorë, është rruga "Ylvi Demiri", jan 3-4 rrugë në Viti pa shtru, janë disa kanalizime pa përfundu. Ne po shtrojmë rrugë në disa lokacione që nuk kalojn 5-6 banorë. Ne duhet me ja kriju qytetarëve komoditetin ku ka banim, jo aty ku nuk ka banim. Unë nuk e di kush shkon atje, kur po shtrohet asfalt ku 5 qytetarë nuk kalojnë në muaj, po këtu veç po më degjoni, se ata që duhet me më kthy përgjigje nuk janë, dhe po të tregoj sot, unë nuk marrë pjesë më në seancë, dalë prej seances nëse nuk është nënkyetari ose kryetari këtu. Çka ka me ardhë, kujt me i bë pyetje, me kanë me fol. Kryetari Haliti gjithhere gjanë arsy, po seancat e ku vendit janë një here në muaj.

z.Basri Sylejmani: Përhendetje të nderuar të pranishëm! Unë kam pyetje për Drejtorinë e Inspeksionit, për çështjen e Germovës prej Ures deri tek ish organizata "Agromoravë" janë tu bë ndërtim. A kanë leje apo nuk kanë a çka janë tu bë, se unë e shof si kauzë, aty nuk po e shof që po ndodh mirë aty.

z.Sejdi Emini: Përhendetje të nderuar të pranishëm! Mu drejtu kolegu Iliri rrëth një pyetje së kyqjes në autostradë. Tha se unë më herët kam thanë që jam i gatshëm për me qenë në interes të qytetarit të komunës sonë. Realisht autostrada është një kronologji në veti. Secili edhe kushdoqoftë duhet ta merr pjesën e fajt të vet. Qytetarët kanë të drejtë të drejtohen siç mu drejtu Iliri, po partitë politike unë mendoj që nuk kanë të drejtë me mu dretju, për arsy se autostrada është kry fun e krye ne Republikën e Kosovës, ndërsa partitë që kanë qenë në pushtet në Viti nuk e kanë parapa fare parasyshë që edhe Vitia duhet të ketë kyqje. Kjo është një ralitet për aq sa di unë, dhe jemi interesu jo vetëm unë, po të gjithë kolegët. Në pyetje janë tri prona për me u privatizu, që me mujt mu hapë rruga dhe mu kry kujja. Qat ditë që dëshmohet që Vitia nuk do të ket kyqje në autostradë, mu para qytetarëve më ki Ilir së bashku me shokë. Kam thanë dhe po thamë, mbi të gjitha e kam qytetarin e Republikës së Vitisë, mirëpo unë me sa di Ilir e kemi një tretuar në Pozharan që ka probleme pronësore, e pa u zgjidhë problemi pronësor as ai tretuar nuk mundet me u rregullu. E kam edhe një kërkesë për dretorin e inspeksionit. E di që i ka pas disa probleme, uroj të gjitha të mirat në familjen e tij. Në pjesën nalt atje mbi Gushicë është një natyrë e mirë aty, e vizitojnë edhe fshatrat tjera, është mirë me dal në teren me e vezhgu gjendjen, sepse është një gjendje po thuaja se e shumtume prej mbeturinave që po i bin edhe prej fshatrave tjera. Kërkoi që të del në teren e të merr masa. Na kë në dispozicion edhe neve për ndihmë.

z.Bekim Azizi kryesues: Partitë tjera kanë maru autostrata, jav kemi lanë qet kyqje, qeta bane.

z.Ilir Zuka: Unë nuk i bëra pyetje Sejdes, e kam përkrah Sejden prej ditës së parë, e din ky se kemi fol edhe jash seancës, edhe nuk kame asgjë kundër Sejdes. Po kërkova një përgjigje nga institucionet, çka ka ndodhë me kyqjen e autostradës, se i kanë lodhë ato qeveritë, thojshin ja po shkojn 30 milion euro, na po e bëjmë me 3 milion euro, e ku kanë mbetë kyqja e autostradës, sepse ju keni thanë qytetarëve që ne e bëjmë për 10 muaj.

Kaluan ketër vite e nuk u bë asgjë. Për tretuarin në Pozharan. Do të kryhet në lagjen “Pira”. Ka mbetë një pjesë e pronës po rregullohet.

z.Bekim Azizi, kryesues: Unë kërkoj që këta grapi i LVV-së me ba një kërkesë e me naj dhanë një informatë për seancën e radhës, me e pa anën zyrtare si është.

z.Nexhat Halili: Pershendetje të nderuar të pranishëm! Unë kam pyetje konkrete. A do të ketë ujë të pijshëm në Komunën e Vitisë? Premtimet kanë qenë se në Komunën e Vitisë do të ketë ujë të pijshëm në shumicën e fshatrave, mirëpo deri tash po shihet se kanë dështuar në këtë drejtim, edhe pse në disa fshatra janë instaluar rrjetet e ujësjellësit, mirëpo ujë të pijes nuk kanë banorët e shumë fshatrave. Janë të detyruar të shkojnë me kilometra dhe të hapin puse me shpenzimet e tyre për ujë të pijes. A keni ndonjë plan se kur këto fshata do të kenë ujë të pijes? Pyetja e dytë, asfaltimi i rrugëve në Komunën e Vitisë. Në komunën tonë janë asfaltu rrugë të ndryshme, mirëpo problemi është që këto rrugë nuk po kanë qëndrueshmëri, shumë shpejt po demolohen intervenohet. Kemi raste, si në rrugën e Sllatinë – Viti, ku është intervenu dikune 28 pozicione, e kemi shume rrugë të tjera që shtrohen me afsalt e brenda një kohe shumë të shkurt prishen. A keni ndonjë kontratë për këto rrugë? Apo bëhet pranimi teknik i këtyre rrugëve? Ndërtimi i tretuareve dhe ndriçimi publik në territorin e Komunës së Vitisë. Është evidente që ka tretuare që janë fillu implementi i tyre, mirëpo siç shihet edhe këtu komuna ka dështu. Shumë trotuare janë në fazën fillestare ose në fazën e mesme po nuk janë në finalizim. Gjithmonë kryetari i komunës del e ban promovimin se ështe rregullu kjo rrugë e është bë ky trotuar, mirëpo siç shihet punët kanë mbet ose në fazën fillestare ose të mesme. Kemi raste si trotuari në Sllatinë, Trestenik. E kam potencu gati në çdo seancë, ejani shiheni në teren siç kanë mbetë.

z.Musli Neziri: Përshtendetje të nderuar të pranishëm! Unë i kam dy pyetje. E para rrëth ndriçimit publik, për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Në shumë lagje në Komunën e Vitisë nuk kanë ndriçim, edhe është një kohë e gjatë në qytet e nëse dilni në mbramje do të shifni duke filluar rrugën prej urës tek stacioni atje e deri thuaja në Drobesh. Rruga kryesore nuk ka ndriçim fare, rruga “11 Marsi” nuk ka ndriçim fare, rruga “Qerqiz Topalli” nuk ka ndriçim fare. Mos t’i numroj rrugët tjera. Vazhdimeshit kemi ankesa nga qytetarët për këtë. Pyetja e dytë, e kam për drejtorin e inspekzionit, e ku drejtorit i uroj mirëseardhej dhe punë të mbarë në këtë drejtori. Po unë e kam pas një shqetësim kogjo moti tek kjo drejtori, në kuadër të komunikacionit, aty e dim që ka pas ndoshta edhe për shak të daljes në pension të zyrtarit që ka qenë aty për shenja të komunikacionit, po megjithatë kemi disa mungesa të shenjave të komunikacionit në qytetin e Vitisë, edhe punimet që janë bë në rrugët e ndryshme në qytet u bë një farë çregullimi i komunikacionit. Ka mungesë të tabelave informuese, ka mungesë të vendosjes së tabelave me urdhër të premë, sepse po ndodhin edhe shqiptime të gjabave nga ana e policisë që ata po e kryejnë punën e vet e po ka ankesa të qytetarëve, që po mungon shenja e po na lan gjobat, prandaj pjesë e kësaj është që bien në Drejtorinë e Inspeksionit. Mungojnë tabelat informuese për rrugë të caktuara, mungojnë tek përparsitë e kalimit. Drejtori të ftoj që të dalin zyrtarët në teren t’i shiqojnë rrugët “Agim Ramdani”, rrugën për tabelë njoftuese prej Pozharanit që vjen ne Viti, kjo rruga e re, mungon, nuk ka fare njoftim aty.

znj.Liridona Bislimi:Përshtendetje të nderuar të pranishëm! Drejtorit të ri i uroj shëndet e punë të mbarë. Unë edhe më herët e kam kërkut që këto emërimet e reja me qenëse janë bë tash të zakonshme në Komunën e Vitisë, është mirë që pikë së pari me u informu me një biografi, jo ndoshta për neve po për qytetarët e Komunës se Vitisë, me e ditë se kush është ai person që po merr pozita të rëndësishme, këtë po e thamë sepse po kemi ndryshime të vazhdueshme të drejtorive. Kam një pyetje për drejtorin e arsimit. Po më intereson ta di si është gjendja e drejtorëve në Komunën e Vitisë sa i përket mandatit të tyre. Dua të pyes a ju ka skadu mandati drejtorëve që janë apo i keni vendos në pozitë të re për shak se qytetarët dojnë me e ditë nëse ata janë në mandatë të vazhdueshëm, e nëse hapet konkursi i ri, kur do të hapet. Pyetjen e dytë e kam për drejtoreshën e financave. Rregullimi i rrugës në trotuarin me kalldrëm rrëth lumi “Morava”. Ne e dimë që është diskutu më herët, mirëpo së fundi është ba një ankesë nga një grup i auditimit. Duhet me cekë që, në këtë projekt që është një kontratë me një kosto mjaft të madhe, mbi 277 mijë euro, edhe përpos ankesave që i kemi pas të vazhdueshme nga qytetarët, tash edhe grapi i auditimit social i përbërë prej 10 personave me profesione të ndryshme, kanë bë analizimin e këtij projekti dhe kanë shprehur vërejtjet te cilësimi i punimeve nga ana e punëkryesit. Më konkretish shqetësimet

e tyre lidhen me punimet tek operatori, si tek shtrurja e kubzave të betonit. Gjithashtu është shqetësues të përmendet edhe qarkullimi i automjeteve me pesha të rënda që po e dëmtojnë infrastrukturën e rrugës, kjo për shkak se, sheja e përshtatshme e trafikut që parashevë peshat është e larguar në skaj të rrugës, dhe natyrisht që nuk shifet nga shoferët e kamionave. Po më intereson me e ditë nëse mundemi me pas naj inforamcion për këtë temë tek pjesa e cilësisë.

z.Ali Bajrami: Përhendetje të nderuar të pranishëm! Riad Sadikut i kisha uru postin e drejtorit të inspeksionit, duke i uruar shëndet e suksese. Pyetje për drejtoreshën e arsimit. Drejtoreshë, tash fillon sezona e dimrit, ngrohja në shkolla: si ka shku procesi i furnizimit me lëndë djegëse në shkolla brenda territorit të Komunës së Vitisë?

znj.Majlinda Shabani: Përhendetje të nderuar të pranishëm! Me shqetëson fakti që nuk e kemi prezent kryetarin e as nënkyetarin. A po i ikun përgjegjësisë, sepse njëherë në muaj kemi mbledhje, e kuj me ja adresu pyetjet. I kam dy pyetje sa i përket procesit të zgjedhjeve në fshatra, dhe pyetjen tjetër e kam për drejtorin e bujqësisë, me konkretish për Sektorin e Blegtorisë: sa është numri i gjedheve në Komunën e Vitisë dhe sa humbje të gjedheve i kemi pas kohës së fundit si rezultat i një sëmundje e cila është shfaq në Komunën e Vitisë. Edhe përpos kësaj e kam përmen edhe në seancat e kalume, më ka interesu me ditë se ku është një lokacioni i destinuar për groposjen e kafshëve të ngordhura, sepse unë nuk kam njoburi se ku është një lokacion dhe çfarë keni ndërmarr ju si drejtori, edhe a e shihni të arsyeshme, se në këtë rast është dasht me ju afru ndihmë fermerëve, në këtë rast edhe blegtoreve që me ju bë, me ju mundësu edhe vaksinimi i kafshëve.

z.Remzi Salihu: Përhendetje të nderuar të pranishëm! Po më doket që ja fillum pak me fushatë zgjedhore, po e kam një sugjerim. Mos pak është herët me ja fillu fushatës?! E do të jetë një moraton e gjatë, e dikush di të lodhet e në fund do të pëson debakël. Po si do që të jetë, po dalë në pyetje e cila më është kërkua nga një qytetar i fshatit Terpezë. Pasi që nënkyetari nuk është këtu, po ja drejtoj drejtoreshës së financave. Deri ku ka arritë procedura e implementimit të projektit per rrugën në fshatin Tërpezë, nga rruga e Qifllakit deri tek rruga “1 Tetori”? A do të kryhet kjo këtë vit?

z.Jakup Demiri: Po i uroj për detyrën e re Riadit, sepse nuk e kam ditë, e kjo e sipërfaq që pernime duhet me u informu qytetarët. Sa i përket punës së kyqjes së autostrades, se jam marrë edhe unë me këtë, është mirë me e pyet ministrin me e marr një përgjigje me konkrete. Janë tri parcela qe duhet mu shpronësu, po me rëndësi që projekti ka kod.

z.Sejdi Emini: Edhe një pyetje. Muajin e kaluar sistemi i arsimit ka pas probleme me paga, e sot është data 31, dita e fundit. A kanë me ju dal pagat punëtorëve të arsimit në Komunën e Vitisë.

z.Valmir Sahiti, drejtor i kulturës: Përhendetje të nderuar të pranishëm! Ilir, me lejo të falenderoj për shqetësimin e ngritur të palestrës në Drobesh. Informatat sa i kam unë, punimet janë duke vazhduar koformë të nje momerandumi i lidhur me 18 maj 2023 mes Ministrisë së Kulturës dhe Komunës së Vitisë, afati i të cilit përfundon me 31.12.2024. Po realisht gjatë gjithë kohës kam qenë i paknaqur me intensitetin e dobët të punimeve, të cilat janë zhvilluar nga kompania punëkryese. Fillimi i pasur një vokum deri sa çështja e momerandumit ka vazhdu në Ministrinë e Kluturës, Rinisë, Sportit, po prej lidhjes së momerandumit nga data 18.05.2023, realish ministria ka qenë e përgjegjshme dhe me kohë të gjitha zotimet i ka përfundu me kohë ndaj kompanisë. Unë edhe nga kjo pozitë shfrytëzoj rastin me i thirrë krejt akterët që janë të përfshirë tek palestra e sportit, duke përfshi ministrin, kryetarin e komunës, Zyrën e Prokurimit, që brenda përgjegjësive ligjore, dhe tu e respektu ligjin e prokurimit, që kompania punëkryese të sanksionohet dhe të futet në penallti, për shak se ka tregu papërgjegjshmeri dhe mos efikasitet në kryerjen e punimeve. Sot kur po flasim në palestrën sportive, janë realizur dikun 60% të punimeve janë edhe 400 mijë euro të zotuara paraprakish që kompania do të mund të i merrte në momentin që kryhet puna, por edhe pas shumë takimeve të progresit që kemi zhvillu edhe me menaxherin e projektit edhe me pronarin e kompanisë ata në vazhdimsi kanë tregu mungesë të përgjegjësisë dhe mungesë së punëve të kryera sipas kontratës së lidhur me Komunën e Vitisë sa i perkete shqetësimet tua të dëmtimeve. Është normale që një projekt që zgjatë 10 vite, që dëmtohet. Po sa i përket aspekteve të dëmtimit ka menaxher të kontratës. Ka ingjinier dhe për ta mundet me fol me mirë aspekti profesional.

z.Riad Sadiku, drejtor i inspeksionit: Përvendetje të nderuar të pranishëm! I morra pyetjet e këshilltarëve. Për disa kam përgjigje e per disa jo. Për këta që nuk kam përgjigje tanë do të ju përgjigjë me shkrim ose në seancën tjetër, e sa per informacionit, unë si drejtor jam emëruar që 5 muaj siç e dini, kam pas gjendjen në familje siç e dini e nuk kam muj me qenë prezen që me vjen keq për këtë, mirëpo në koordinim me inspektorat e punëtorë aty në drejtori nuk ka munguar, kemi pas vazhdimit kontakte, po edhe unë kam ardhur shpeshhere prej Turkis që mos mi ndal proceset. Tek pyetja e parë ishte tek posta, po jam në dijeni, inspektorët kanë dal në teren dhe i kanë kërkuar lejet e ndërtimit të gjitha atyre që i kanë barakat. Ato që nuk janë të pajisur me leje, janë inicu procedura të mëtutjeshme gjyqësore, që janë kompetencë e inspektoratit. Ato që janë në rregull vazhdojnë punën tek rruga "Hasan Prishtina" që e ngriti çështjen Taulanti. Ne kemi pas siç e dini mungesë të inspektorëve. Para disa jave është emru inspektori i komunikacionit dhe i kemi rendit të gjitha ato dhe do të shqyrtojmë edhe atë kërkesën e juaj, tek pyetja e Basris nuk jame i informuar per kete do të jemi të gateshem me dal në teren tek Musli Neziri që beri pyetje shejat e komunikacionit tash e kemi emeru inspektorin e komunikacionit ka marr detyrën e kemi kordinu punët tash do të jemi në tëren do ti ivedintojm të gjitha shejat se edhe e kame primare që mos te ket as një rrugë pa evidentuar me sheja të komunikacionit horizontale dhe vertikale, nëse ka pyetje tjetra adresoni tek drejtoria e inspeksionit, pytja e Sejdi Eminit tek mbeturnat ne Goshice inspektoret nuk e din se ku ka mbeturina se pari dueht mu adresu nga qytetaret që ne me dal ne teren.

z.Bekim Azizi, kryesues: Drejtor, pyetjet që bëhen nga këshilltarët komunal janë njëjtë si me shkrim si me gojë që bëhen. Ti e merr pyetjen, nëse nuk ki përgjigje e kthen në seancën e radhës ose me email.

z.Naim Pira, drejtor: Përvendetje të nderuar të pranishëm! Pasi që jam tu e zëvendësu edhe drejtorin Basri Aliu, u bënën edhe disa pyetje. Për këtë i kam shënu pyetjet. Do të ja përcjelli pyetjet, në seancën e radhës do të ju jep përgjigjet. Pyetje që ishte për drejtorinë time nga Majlinda, për numrin e krerëve të gjedheve në Komunën e Vitisë rrëth smundjeve prezent që janë aktualisht dhe rrëth groposjes së tyre. Gjithmonë ju referohem statistikave që merren gjatë kohës së aplikimit të subvencioneve në komunën tonë nga ana e fermerëve. Unë për me pas numrin e sakt dhe në bazë të statistikave, lopë qumështore mbi pesë krerë në Komunën e Vitisë i kemi 1527 lopë, d.m.th që kanë aplikuar për subvencione, mushtjerra i kemi 192, dele për mbarsim mbi 30 krerë i kemi 8037 dhe dhi për mbarsim i kemi 711, dosa mbi dy krerë i kemi 45. Ky është numri i gjedheve në përgjithësi në Komunën e Vitisë. Sigurisht numri është më i madh, sepse ka familje që i kanë nga një, dy, tri, po për këto nuk kemi shëname. Sa i përket smundjes, është prezent tuberkoloza. Kanë identifiku deri tash 19 krerë që i ka asgjesu në Komunën e Vitisë, po dua të ju thamë që kjo është detyrë ekskluzive e AVUK-ut. Ne si Drejtori e Bujqësisë absolutish nuk kemi qasje, përpos që kam marr një informatë nga mjetet e informimit. Natyrisht që kam kërkuar informacione nga inspektorët e AVUK-ut dhe ata na kanë njoftuar që 19 krerë i kanë asgjesu. Janë duke e përcjell gjendjen, ka akoma, kanë fillu edhe delet, ndërsa sa i përket groposjes së tyre, e di që më herët ka qenë një vend dikun mbi Bagdat, ndërsa me planin e ri zhvillimor urban nuk e di ku është i përcaktum.

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Përvendetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket rrugëve nuk kam përgjigje për pa u konsultu me ingjinierat, menaxherat, sepse ata janë kompetent. Shpresoj që jav dërgoj përgjigjet me email. Për rrogat kam qenë dje ne takim tek ministria. Po, dalin rrogat këtë muaj. Nëse doni një sqarim të shkurt për muajin e kaluar e kisha dhanë. Muajin e kaluar thuaja se të gjitha komunat kanë problem përtej mujit. Edhe në komuna Drejtoria e Financave ka dhanë leje me i marr të gjitha ato ku e kanë parapa me i marr dhe kanë qenë të planifikuara po mendoj për gjithë Vitinë pagat. Po me qenëse kontrata kolektive ka pas shumë pagesa dhe naj kanë marr 5 milion, kështu që me ligj nuk kanë të drejtë tek investimet kapitale me i marr mbi 15% edhe kanë marr te pagat, subvencione, mallra dhe shërbime, të gjitha kategoritë dhe na i kemi gjithsej 3 milion investime kapitale, po neve naj ka marr 5 milion edhe është bë ajo ngatresa dhe i kanë marr pagat tetor, nëntor, dhjetor dhe i ka bë të gjitha bashkë që me i kalu muajin e shtatori, dhe tash çka ka met një 167 mijë euro i kemi pas që ka pas të drejtë me i marrë. Po unë kam shku, kemi mbajt takim dhe u rregullu, e kemi bë kërkesën për rimbursim qysh para tre muajve, po nuk u kthy asnje përgjigje. Prapë i kemi bë, që dy javë ren jemi tu e bë, dje isha në takim, thanë rrogat ju dalin, kështu që po e presim.

z.Taulan Haxhiu: Drejtoreshë, e pse vetëm Komuna e Vitise ka pas problem?

znj. Milihate Ajeti, drejtoreshë: Kanë pas thuaja se të gjithë, po Vitia nuk ka kapacite prej të hyrave vetanake 10 milion si komunat e tjera. Në 3 milion i kemi krej investime kapitale për krejt vitin, e 5 milion naj kanë marrë, mirëpo me kontratat kolektive kanë problem të gjitha komunat.

z.Jakup Demiri: Drejtoreshë, më mirë ke me naj dhanë informatë se a dalin pagat, se çka ka ndodh në muajin e kaluar e dimë, se vetëm Komuna e Vitisë nuk i ka marr pagat. Kronologjia se si ka ndodhë e dim edhe e kemi diskutu, e mos u mundo me e hudh fajin dikun tjetër kur faji ka qenë te komuna.

znj. Milihate Ajeti, drejtoreshë: Dje kur isha në takim unë, krejt e kanë pas këtë problem, po janë kanë tri komuna që janë kanë si në zero zero zero. Këtë here nuk jemi vetëm ne.

z.Sejdi Emini: Ka mujt mu zgjedh problemi në ditën e parë e jo me pritë dhjetë ditë.

z.Musli Nezir: Drejtoreshë, pasi që u diskutu për paga, e kemi piken e pasqyrrat, po pagat në arsim e dimë si janë ekzekutu, pas dhjetë dite vonesë, por unë e kam edhe një shqetësim tjetër, sepse ne jemi një pjesë e kolegëve këtu që nuk kemi marr fare paga për kuvend, për punën që e bëjmë nuk kemi pagu, jemi dikun pesë veta.

z.Berat Zuka, ZKF: Përvendetje për te gjithë! Një sqarim të shkurt. Kur po përmendet fajtori, pagat e muajit shtator, se unë kam qenë direkt me zëvendësdrejtorin e thesarit në shtator, nuk kanë mujt mu pagu se ka qenë diferenca e vlerës prej 167 mijë euro. Ne e dimë që nga viti 2023 dhe 2024 kesh plani përgaditet për çdo muaj edhe ata me i pas gjetë mjetet e lira nuk na kishin pyet neve. Deri tash naj kishin marr me përmbarues privat e bë pyetja. E pse në muajin tetor u pagu. U pagu se me 2 tetor e kam bë kërkesën e mjeteteve të pashpenzuara nga muaji korrik, gusht, shtator ku janë mallrat dhe shërbime, të gjitha mjetet që kanë qenë kesh, pra i kemi bart, me datën 5 tetor i kemi bart mjetet dhe atëhere ka qenë mundësia e tyre me e plotësu shumë prej 167 mijë euro, kurse në shtator nuk ka pas mundësi, se thesari prapë sikur ekzekutimet tjera nuk na kish pyet, po nuk ka pas mjete të lira.

z.Nexhat Halili: Pjetje për drejtoreshën e financave. Sa janë projektet kapitale për 2024 sipas buxhetit, sepse ti e potencove që janë tre milion. Tash unë i kam do lista këtu që po dalin pak ma ndryshe.

z.Berat Zuka, ZKF: Nexhati është tu i pa shënimet e raportit finanziar. Në raportin finanziar në nëntëmujorin e shpenzimeve, grandi qeveritar përfshihet në tërësi. Në tabelë të hyrat vetanake janë planifikuar, po ende nuk e kemi mri realizimin, plus donacionet, mjetet e pashpenzuar 2023 që jan bart në 2024.

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë: Përvendetje të nderuar të pranishëm! Kam pyetje nga Liridona sa i përket gjendjes së drejtorave, ushtrues detyre i kemi tri pozita. Për momentin jemi në konsultim për shpalljen e konkursit për drejtor të shkollave dhe besoj që shpej do të procedojmë me konkurs. Siç e dini, tash e kemi edhe një rregulllore për rregullimin e procedurave për konkurin për drejtor dhe stafë. I nderuar Ali, e bëre pyetje për sezonin e dimrit për procesin e furnizimit në shkolla. Fillimi i kemi testuar thuaja të gjitha nxemjet. Po ashtu janë furnizu të gjitha shkollat me dru dhe kemi intervenu aty ku kemi pas nevojë, kështu që jemi të gatshëm për sezonën e dimrit.

z.Bekim Azizi, kryesues: Materialin e keni marrë me kohë. Pikën e gjashtë të rendit të ditës, propozim për miratimin e draft kodit të etikës për zyrtarët e Komunës së Vitisë, terhek kjo pikë, edhe pse ka kalu në KPF, sepse në bazë të Ligjit për Zyrtar Publik, kodin e banë ministria. Për këtë seancë kemi parapa këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Kuvendit Komunal.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-shtator 2024.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm publik.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi në Komunën e Vitisë.
5. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në DKRS gjatë vitit 2024.
6. Informatë nga DKA-ja mbi fillimin e vitit të ri shkollor.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi diskutim për rendin e ditës. Pasi që nuk ka për diskutim: a jeni që të miratohet rendi i ditës pa pikën e pestë e cila u terhek? Pra, me të gjitha votat pro miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Kuvendit Komunal

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim. Atëherë, me 17 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim miratohet procesverbal.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-shtator 2024

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Përvjetorë për tē gjithë të pranishmit! Matrialin e keni marr me kohë, kështu që nuk po ju marrë kohë, kodet të cilët i keni kërkuar në KPF ju kam dërgu sot. Për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ali Bajrami: Drejtoreshë, faleminderit për elaborimin e kësaj pike të rendit të ditës. Shpenzimi i buxhetit është në korniza të buxhetit që është miratu dhe ju përgëzoj për punën dhe angazhimin që e keni bë. Ajo çka është për tu vlerësuar është se, shpenzimi i buxhetit në këtë periudhë kohore në përqindje që është shpenzu është shumë i mirë. Besoj që do ta ndjekim trendin, deri në fund të vitit kalendarik do të mbrrim që të shpenzojmë si vitet e mëparshme. Duhet të behet përpjekje që të hyrat vetanake të rriten, sepse janë të hyra që mblidhen dhe janë të hyra që direkt i shfrytëzon qytetari i Komunës së Vitisë. Edhe tek investimet shpenzimet kapitale vërehet dhe është shpenzu në mënyrë shumë të mirë mos me hi në përqindje. Ajo çka më ra ne sy që kisha pas dy pyetje është tek kodi 13430, shërbimet e ndryshme shëndetësore 369 mijë e 632 euro dhe e kemi kodin 13440 shërbime këshilldhënëse dhe profesionale 118 mijë euro e 927 euro e 50 cent.

z.Jakup Demiri: Tek pasqyrat financiare ne në mbledhje të KPF-së e kemi be një ser pyetje për tē cilat e keni sjellë një listë. Tani po mungoj, edhe nja dy tri pyetje. Tek kodi 13430, shërbimet shëndetësore të angazhuar, infermier dhe mjekë përmes Karitasit ne QKMF. A mundesh me na shpjegu me detajisht për këtë. Tek kodi 13440, shërbime këshilldhënëse dhe profesionale janë marrëveshje me Agjencinë e Zhvillimit Rajonal, ku janë të angazhuar 5 konsulent dhe kontrata e studimit të fizibilitetit për shpenzimin e energjisë në objektet e arsimit, shëndetësisë dhe administratës, kodi 13440 e kap shumën prej 118 mijë 927 euro dhe kodi pasues 13445, shërbime të veçanta, konsulent dhe kontraktor individual 37 mijë e 862 euro. Po më intereson çka kanë bë këta, se kemi informata prej terenit që, këtu nuk ka zhvillime aktivitete. Në këto janë pyetje më shumë se 150 mijë euro, e ne e dimë problematikën e kësaj kontrate, e cila kontratë na e qonë në kollaps komunën tonë. Kodi 14032, mirëmbajtja e rrugëve lokale, që është 258 mijë e 205 euro dhe kodi tjetër 14060, mirëmbajtja rutinore prej 30 mijë. Cili është dallimi në këto? Edhe tek faqja 24, hartimi i projekteve, është Florent Emini, e ka një kontratë prej 215 mijë e 384 euro. Unë kam kërkua cilët projekte i ka hartu, ndërsa përgjigjja është që, Florent Emini është biznes individual që ka kontratë me komunën për hartimin e projekteve të asfaltuara, rrugëve, ndërtimin e kanalizimit, ndërtimin e ujësjellësve etj. Nuk është precizu, e unë bëjë pyetje konkrete, në cilët projekte është bë, kur e dimë që Florent Emini vitin e kaluar në pasqyrat financiare nuk figuron ashtu, po unë edhe po pyes: a i ka marr përmes përbartuesve vitin e kalur? Që i kishmi në pasyra financiare në muajin shkurt të këtij viti, që ishte shuma e pagesave 145 mijë euro. A i ka marrë me përbartus apo si i ka marrë këto mjete? Qekjo 14032, shpenzimi i mirëmbajtjes se hapësirave publike dhe rrugëve përmes kompanive të kontraktuara hapësira publike, kemi shumë. Unë nuk e di nja që është mirëmbajt. I shof nja tri a katër në fshatin tim edhe ka të vijë në Viti te varrezat e dëshmorëve aty me poshtë që janë, e aty ato luleset që kanë qenë janë demolu, nuk figuron si hapësirë gjelbëruese e si park i rregulluar. Kompania nga Lipjani, zyrtari i autorizuar është gjeodeti Fadil Haziri, dhe kemi të bëjmë me projektin e lumi "Morava", pagesa është kryer me vendim të gjykatës rreth 110 mijë euro. Kisha me pyet ose e bjen muajin tjetër. Ky i ka marr 110 mijë euro e aty nuk ka bë aktivitet. Çka është problematika?

z.Taulant Haxhiu: Po lidhem tek kodet. Nuk është vlerë e madhe, po ja vlenë me diskutu. Tek kodi 13250 janë 6746 euro vlera e telefonisë fikse. Nuk po e di çka përdoret telefonia fikse. Kodi 13501, mobile 92 mijë 389. Na prapë dikun 12 mijë euro në muaj po i shpenzomi per mobile. Qaq shpesh duhet mu ndërru a? Rregullimi i hapësirave publike gjelbëruese i ka marrë 27 mijë e 536 euro. E ki qitë tek faqja 23 e ki “Arber Grup”, prapë tek faqja 23 rregullimi i hapësirave gjelbëruese 37 mijë e 574 euro. Rregullimi i fushave sportive 259 mijë e 999 mijë euro, “Euro Komerçi”. 28 mijë e 777 euro kemi shpenzu ne muaj për rregullimin e fushave sportive. Në Tërpezë e keni ndërru gomën, e keni lanë qashtu tek “Bafti Haxhiu”, nuk keni bë kurgja. Në Kabash nuk keni bë kurgja. Unë nuk po e di qysh 29 mijë euro me shku në muaj për rregullimin e fushave sportive, kur disa fusha janë tmerr me i pa. 119 mijë e 24 euro ti ka marr “Misini Llap”, për mos pagesa, përmbaruesi ti ka marrë. Është mirë qeto kode me mi sqaru.

z.Ilir Zuka: Përsendetje drejtoreshë! Faleminderi për sjelljen e materialit edhe kodeve. Tek të hyrat vetanake kemi më pak, po me siguri ka ndiku vendimi për faljen e tatimit në pronë.

z.Nexhat Halili: Tek realizimi i buxhetit nga te hyrat vetanake, më brengos fakti që kemi ngecje nga të hyrat vetanake në inkasim në krahasim me vitin 2023. Të hyrat këtë vit janë më të vogla për 281099, në përqindje 25.61% janë më të vogla. Nga kjo shifet se mos inkasimi i mjeteve nga tatimi në pronë, difirencën më të madhe e ki tek tatimi në prone për të hyrat vetanake, ku në vitin 2023 kanë qenë 656546. Tash e ki 331888, që do të thotë 324676 euro i ki minus. Tek tatimi në pronë vitin e kaluar si duket ka ndiku edhe përmbaruesi që inkasimi ka qenë më i madh. E këtë vit ose nuk e keni angazhu përmbaruesin ose nuk e di se çka është problemi. Te shkalla e realizimit të buxhetit janar-shtator 2024, shpenzimet janë 15 milion e 415 mijë, ose 96.26% kështu siç e keni paraqitë ju e buxheti i aprovuar per vitin 2024 ishte në vlerë 16 milion e 653191, por edhe aty kur e keni përgatit buxhetin 5000 euro, diferenca që ka qenë 16 milion e 658191, ndërsa tash pas pasqyrave financiare keni 17 milion e 843024 euro per nëntë muaj, a buxheti është për dymbëdhjetë muaj, që e keni defirencë 884 mijë e 833.66 euro. Unë e kuptoj se, pak me herët e patëm edhe me Beratin diskutimin, mirëpo nuk muj me thanë tash për të hyrat vetanake, sepse të hyrat vetanake i keni me të vogla këtë vit. Mundeni me deklaru se, bartja e mjeteve prej vitit të kaluar këtë vit edhe donacionet, ama jo prej të hyrave vetanake. Të hyrat vetanake janë më të vogla. Drejtoreshë, tek buxheti gjatë llogaritjes së pasqyrave tek pozicioni, kodi 1131, kontributi pensional i punëtorit dhe kontributi pensional i punëdhënësit. Aty e keni një dallim në baze të Ligjit të Administratës Tatimore, parashihet shkalla e përqindjes së kontributeve prej 5 deri 15%, por gati shumica e aplikojnë 5% ose ju ka lëshu naj gabim teknik ose keni desh me i barazu pasqyrat, nuk po e kuptoj këtë. E keni diferenca 195 euro në pozicionin tek faqja numër 27, kontributi pensional i punëtorit dhe kontributi i punëdhënësit. Nëse shkon 5% për punëtorin shkon edhe 5% për punëdhënësin. E kështu tash kam pyetje për drejtoreshën e shëndetësisë, shërbimet e ndryshme shëndetësore në vlerë 369 mijë 632.69 euro. Pyetja është çka përfshihet në këto. Unë e di që është një kontratë me Karitasin, e cila është në vler prej 700 mijë euro, e kontrata ka hy në fuqi me 11.12.2023 deri me 10.12.2025. Po unë po bëjë pyetje, çka përfshihet në kuadër të kësaj kontrate? A përfshihen edhe angazhimi i personelit? Kur me Ligjin e Financave. Tash po e pyes drejtoreshën e financave bazë, çka u bë pagesa prej shërbimeve dhe mallrave apo prej cilit kod, ku prej shërbimeve dhe mallrave dijet që nuk lejohet bartja e mjeteve për punëtor. Pyetja tjetër, shpenzimet e anëtarësimit. Çka përfshihet në shërbimet e anëtarësimit? I ke 8 mijë e 54805 euro. Drejtoreshë, pajisjet tjera, kodin e ki 13480. Unë e di çka përfshihet anëtarësimi në Asociacionin e Komunave, mirëpo diferenca prej vitit të kaluar me këtë vit, pse, çka ka ndryshu, është rritë tarifa. Kodi 13059, pajisjet tjera çka përfshihen. Tash po del tek investimet kapitale, tek ndërtimi i palestrave shkollore. I ki dy palestra, një në Sllatinë të Epërme dhe palestrën e “Kuvendit të Lezhës”. Kontrata për te “Kuvendi i Lezhës” është lidhë me 12.12.2023, ndërsa në Sllatinë të Epërme është lidhë me 22.04.2024. Vlera e kontratës së “Kuvendit të Lezhës” është 362 mijë e 805 euro, ndërsa e Sllatinës 468 mijë, që do të thotë në total janë 831 mijë e 708 euro. Buxheti i ndarë për këto dy projekte, edhe pse në buxhet i keni inkorporu me një pozicion, ndërsa tash tek pasqyrat i keni nda. Buxheti është për katër vite, që në realitet buxhet për katër vite nuk ka, po duhet për tri vite. Vitin e parë e ki 100 mijë euro në vitin 2024, në vitin 2025 e ki 100 mijë, në 2026 e ki 90 mijë, në 2027 e ki 148 mijë 903, do te thotë 438 mijë e 903 euro. Diferanca është dikun 300 mijë euro përafërsish. Ku

i merrni këto pare për me i realizu këto projekte? Këtë planifikim unë e kam nxjerrë bazë listës që ju e keni dorëzu këtu në Kuvend. Edhe një pyetje tjetër tek vendimet gjyqësore të investimeve kapitale. Në bazë të llogarisë së juaj i keni qit dikune 84.96% janë realizu investimet kapitale, mirëpo në bazë të një llogarie që unë baj, që këto vendimet gjyqësore largohen, se ato nuk janë investime kapitale, nuk mudeni me i qujt investime kapitale. Ato janë vendime gjyqësore. Nuk ke ba asnë projek kur e regjistron ato. A e regjistron si rrugë të shrume apo si? Nuk ke bë kanalizim, nuk ke bë ujësjellës, trotuar. Mu më del 75.74%. Kur të largohen këto vendimet gjyqësor, por këto pasqyra janë edhe shumë të bartura prej vitit të kaluar, se në bazë të shpenzimeve okej, po në bazë të investimeve nuk del kjo përqindje, se investimet janë, llogariten në ketë vit jo në ato se ato janë shpenzime që barten prej viteve të kaluara në vitet tjera.

zpj. Malinda Shabani: Edhe unë deshta me u ndërlidh sa i përket pasqyrave financiare, sepse në fund të fundit, sa i përket shpenzimeve të parave publike, na e dimë që qytetarëve të Komunës së Vitisë ju intereson me ditë se ku realisht janë shku ato mjete financiare dhe se sa janë tu ja lehtësu mirëqenien qytetarëve investimet që janë tu bë në Komunën e Vitisë. Ne e kemi pa që, në mbledhjen e KPF-së kemi kërkua informacion konkret për sa i përket disa kodeve bugjetore, edhe informacionet që na kanë ardh shtesë kanë ardh të njëjtë, nuk kemi sqarim se ku realish janë shku ato mjete financiare. Për sa i përket pajisjeve tjera, ku ështe kodi 13509, janë dikun 337 mijë euro të shpenzura, ku për pos kësaj thuhet që janë shpenzu për arsim, shëndetësi, administratë, vendosja e pajisjeve për ndriçim publik sipas kontratës për shërbime të energjisë në Komunën e Vitisë. Për sa i përket ndriçimit publik, tash e tre vite unë si asambliste që jam, kam ngritë shqetësimë të vazhdueshme për sa i përket fshat Lubishtë, ku ky fshat është gjysëm me ndriçim publik e gjysma pa ndriçim. Andaj, unë sot po e bëjë pyetjen konkrete, se pse fshati Lubishtë ka mbet pa ndriçim publik, përderisa janë tu shpenzu mira a miliona euro për çdo vit, shërbime këshillëdhënëse dhe profesionale, janë dikun 119 mijë euro, ku bëhen kontratat sa i përket studimit të fizibilitetit të shpenzimeve të energjisë në objektet e arsimit, të shëndetësisë dhe administratës. Unë kisha dashtë këtu edhe një arsyetim, sepse u dashtë me bë një kontratë të tillë edhe për sa i përket studimit të fizibilitetit, sepse me që e dimë, nuk është që kemi pas praktika të mëhershme për sa i përket këtyre kontratave. Është një shpenzim që është tu bë dhe është mirë me dhanë edhe arsyetimin se pse është nevoja me bë një shpenzim të tillë për sa i përket mirëmbajtjes së objekteve, pastrimi i cili bëhet përmes kompanisë së kontraktuar, janë dikun 246 mijë euro. Nuk keni dhënë infomracione se ku janë tu mirëmbajtë ato objekte, shpenzimet e mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe rrugëve që bëhen përmes kompanive të kontraktuara, i ki dikun 259 mijë. Po besoj që qytetarët e Komunës së Vitisë e kanë pa dhe e shohin për çdo ditë se sa janë tu mirëmbajt realisht këto hapësira publike. Unë nuk i di se ku janë tu shpenzu keto para, vetëm në kete gjashtëmuajr e kemi një shumë bajagi të madhe. Sa i përket kompenzimit të përfaqësimit brenda vendit, dreka zyrtare, duke përfshi edhe përvjetorë për manifestime tradicionale, edhe këtu nuk është që keni dhënë informacione shtesë, pastaj po ndërlidhem pak tek investimet kapitale, sepse pajtohem që te prezantimi analistik i investimeve, investimet që janë paraqit nuk i përkojnë kohës për të cilën ne jemi tu raportu për sa i përket pasqyrave financiare edhe këtu kemi shpenzime të cilat për mu janë shumë shqetësuese, kuptohet për çdo vit ne bëjmë rregullim të fushave sportive, edhe po besoj që në emisionin e fundit që e kemi pas me kallzo.com, ne e kemi pa se çfarë punime bëhen. Për sa i përket fushave sportive, e unë e kam edhe një foto që shifet se qysh po keqperdoret paraja publike. Tjetra është sa i përket riparimeve në shkolla, ndërtimi i palestrave sportive, e pasmi drejtoreshën këtu. Unë i kisha bë ftesë që me shku me pa sallën e edukatës fizike që është te shkolla "Januz Zejnullahu" dhe me i pa që a i plotëson kriteret për me ushtru nxënësat sa i përket lëndës së edukatës fizike. Janë asfaltimet e rrugëve rurale, ndërtimet me zhavar që bëhen për secilën periudhë që jemi tu raportu në kuvend komunal. Na nuk e dimë se ku janë tu bë ato asfaltimet, edhe përpos kësaj shqetësuese është kualiteti i atyre punimeve, është shumë i dobët. Ne e kemi bë edhe një kërkësë tjetër në KPF që nuk kemi marr informacion se sa prej këtyre investimeve që janë bë dhe rrugët që janë asfaltu kanë pas pranim teknik, sepse edhe ky informacion na duhet në kuvend komunal me pas, se sa prej tyre kanë pranim teknik dhe sa prej tyre janë pa pranim teknik. Përpos kësaj është edhe mbikëqyrja e punimeve, edhe këta duhet me ditë se sa janë tu mbikëqyrë punimet e jo me pas ne probleme. I kemi dy investime që janë tu bë, pikërisht në qendër të Komunës

së Vitisë sheshi, e që kemi kërku prapë informacione. Na keni thanë që është projekt dyvjeçar, mirëpo nuk është ka mbikëqyret dhe nuk e di se sa mendje ky projekti që është tu bë e ka blloku sheshin tash e një kohë. Ideja është që me jav lehtësu qytetarëve të Komunës së Vitisë qasjen që ata e bëjnë për çdo ditë, edhe pjesa tjetër që e kemi përmen përreth lumi "Morava". Unë kisha dashtë shumë që në këtë seancë të kuvendi komunal me qenë e nënkyetari këtu, që mos me e harru mendje edhe çështjen e ujit të pijshëm, sepse e kemi përmend në çdo seancë, e unë po shpresoj që deri në fund të mandatit, mandje edhe kur mrrim në fushat, kryetari Haliti me dal madje me tregu edhe në mënyrë se si e ka zgjidhë këtë problem, edhe prej kujt u zgjidhë ky problem përmes kontratave që janë shkru kohën e fundit, dikun në vlerë 5 milion euro që është prej ministrisë.

znj.Melihate Ajeti, drejtoreshë: Po ju përgjigjем pyetjeve. Kodi 13509, këtu hin dekorimi i qytetit përfestat e fundvitit, shërbimet e energjisë përfiqencë dhe furnizimi napër shkolla, administratë dhe shëndetësi. Kodi 14032 dhe 14060, d.m.th rutinor, është një kontratatë që kemi punëtorë që mirëmbajnë rrugën, i pastrojnë rrugët, këtu hin krejt çka e mirëmbajnë pastrimi. Hapësira gjelbëruese te koka tek investimet kapitale, kështu që pa u konsultu me ingjinierat, menaxherat nuk po e di sigurt. Kodi i telefonisë fiksë që ke aty, janë në të gjitha objektet. Tek shëndetësia janë të kyqyra me rrjete e mandje përkëtë bëhet pagesa. Janë administrata, financat etj. Kodi 13430, shërbimet shëndetësore të angazhuar infermierët dhe mjeketë përmes Karitasit te QKMF-së. Këtu hinë edhe shërbimet shëndetësore të angazhuara, edhe infermierët, mjekët përmes Karitasit.

z.Nexhat Halili: Prej kujt bëhet pagesa e kësaj kontrate të Karitasit?

znj.Melihate Ajeti, drejtoreshë: Mallra dhe shërbime bëhet pagesa për Karitas.

z.Nexhat Halili: A lejohet përpunëtorët këtu mu bë pagesa?

znj.Melihate Ajeti, drejtoreshë: Aty tek shërbimet shëndetësore hin edhe ato çka shkojnë nëpër shpija, ato hargjime janë këto.

z.Nexhat Halili: Po ju e bani pagesën edhe përmjek e infermier me qat kontratë, 5% i kontributit të punëtorit dhe të pronarit.

znj. Melihate Ajeti, drejtoreshë: Të gjitha kodet që i këruat do të jav përcjelli me shkrim.

z.Bekim Azizi, kryesues: Berat, nëse banë një pyetje në nëntëmujorin, pjesa e pagave janë vetëm 350 mijë e 591 euro, është pjesa e të gjitha kodeve tek paga dhe mëditjet. Tash paga që na del e dimë që shkon dikun afér 1 milion. A shkon prej buxhetit të komunës apo i rimburson qeveria, a ki informatë?

z.Berat Zuka ZKF: Në tremujorin e tretë të këtij viti, totali i buxhetit që është miratu prej 9 milion 592 mijë euro, vetëm 587 euro në total të komunës kanë mbet të lira, të tjerat nuk ështe gabim i komunës ose neglizhencë, të tjerat nëse nuk rimbursohen nga niveli qendror, atëherë jemi për 2 milion e 350 mijë euro komuna është minus në vitin 2024, pa paga, mirëpo kërkosat tonë të vazhdueshme prej ministrisë dhe departamentit e buxhetit, pjesa e pagave ka dal prej qeverisë rimbursim.

z.Jakup Demiri: Tek kontrata me Karatasin, nuk e di si është tanë, më herët ka kogjo kohë që nuk e kemi pa, a unë e di që një kontratë në vitin 2017 ka qenë 100 mijë euro Kontrata me Karatasin, e ku ka shkru që janë për shërbime në familje, tek pacientët me smundje të rënda vetëm 2000 euro në 2017. Muj me gabu me vite, kanë qenë të shpenzume për shkak të lidhjes së kontratës 98 mijë euro ose 98% e kontratës ka qenë e shfrytëzume përdicë tjetër, ka qenë e shfrytëzume përfushatë, që njëherë me kontrata mbi vepër. Është mirë me naj pru qet kontratë me pa na. Edhe tjetra që thave, tek kontrata përmirëmbajtje, që ka punëtorë e ka një kompani e cila, unë kam informatë që dy paga nuk janë punëtorëve pagën e janarit dhe ju thotë që nuk keni punu. Është mirë me u interesu ju këta punëtorë kanë pas një takim me drejtori Basri, ndërsa pronari i kompanisë i ka kërcnu që edhe ju qes prej punës krejt.

z.Ilir Zuka: Unë po mendoj që Jakupi e ka përkontratë përmirëmbajtje.

z.Nexhat Haliti: Është publiku kontrata e përgjithshme, po specifikat jo. Kur të kërkon ne web të komunës, dalin të mangëta informacionet.

z.Bekim Azizi, kryesues: Faleminderit përkontributin e dhënë në këtë pikë! Vazhdojmë me pikën.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm publik

z.Naim Pira, drejtor: Para juve e kemi sjellë raportin e vlerësimit të dëmeve, të cilin raport e ka bë komisioni i formuar nga kryetari i komunës. Materialin e keni marr me kohë. Për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

z.Bekim Azizi, kryesues: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Remzi Salihu: Tek kjo pronë, a është tretuari i ndërtuar aty? Nëse po: si është bë ndërtimi i trotuarit në pronën private? Po e falenderoj pronarin i cili nuk e ka paditë komunën deri me tanë.

z.Bekim Azizi, kryesues: Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit, me një votë kundër, të tjerat pro, u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi në Komunën e Vitisë

z.Naim Pira, drejtor: Para juve e kemi sjellë raportin e vlerësimit të dëmeve, të cilin raport e ka bë komisioni i formuar nga kryetari i komunës. Materialin e keni marr me kohë. Për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

z.Bekim Azizi, kryesues: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Musli Neziri: Drejtor, prej 33 kërkesave i keni cek, që 7 kërkesa janë refuzu, 4 kërkesa në polici, një kërkesë është cedu, nuk po e kuptoj këtë.

z.Naim Pira, drejtor: Kjo kërkesë ka ardh gabimisht. Në drejtorinë tonë dhe ne e kemi cedu në drejtorinë përkatëse.

z.Bekim Azizi, kryesues: A jeni që të miratohet kjo pikë? Me të gjitha votat miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Informatë mbi ndarjen e subvencioneve në DKRS gjatë vitit 2024

z.Valmir Sahiti, drejtor: Përhendetje të nderuar të pranishëm! Me lejoni që para juve të prezentoj informatën mbi ndarjen e subvencioneve në DKRS gjatë vitit 2024, duke u bazuar në ndarjen buxhetore për subvencionet në DKRS. Gjatë vitit 2024 Komuna e Vitisë ka hapur thirrjen publike për OJQ-të në fushën e kulturës, rinasë dhe sportit, konform rregullores 04/2017, kemi përzgjedhur komisionin vlerësues në përbërje te të cilit kanë marrë pjesë edhe një anëtar nga shoqëria civile edhe një nga OJQ-të. Komisioni vlerësus ka nxjerrë rezultatet preliminare nga 31 OJQ-të aplikuese janë përzgjedhur si përfituese 27 OJQ dhe janë refuzuar 4 OJQ në mungesë të dokumentacioneve. Materialin e keni marrë me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

z.Bekim Azizi, kryesues: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ilir Zuka: Drejtor, a ka të drejt një OJQ me marr mjete në Kllokot, Gjilan e në Viti? A janë të gjitha këto OJQ-të ekzistuese funksionale? Edhe tek 24 po e shof këtu për Izja Aliun, çka ka ndodh këtu, çka është e zbrazët?

z.Sejdi Emini: Përhendetje të nderuar të pranishëm! Pra, duke u mbështetur në vendim përfundimtar të DKRS-së, me numër të Vendimit 12-035-02714, shihet nga thirrja publike e kësaj drejtorie kanë përfituar plotë 27 të ashtuquajtura OJQ, pasi që thirrja publike ishte për OJQ-të e Komunës së Vitisë. Pra, nga DKRS-ja kanë përfituar gjithsej kategoria e sportit 13 OJQ, kategoria kulturë 8 OJQ, kategoria rini 6 OJQ. Sipas një llogaritje të thjeshtë, paraja publike e taksa, pagesa të qytetarëve duket kështu: 51900 euro sport, 37800 kulturë, 10950 rini. Gjithsej 100 mijë e 650 euro. Pra, DKRS-ja ka një përgjegjësi, sipas saj a ka qenë ndonjë OJQ konflikt interesi i përfitimit, sepse siç shihet këtu, shefi i prokurimit, z.Fadil Abazi, i cili është edhe nënshkrues i përfitimit të OJQ-së, ka qenë përfitues. Po ashtu kemi OJQ që kanë përfitë babë e bir. D.m.th, prej një familje, dy. Mendoj që nuk ka qenë kjo në rregull. Po tashti do doja të dija që përfituesit e subvencioneve a kanë qenë të gjitha në

rregull, konkretisht a kanë patur fushëveprimet e tyre sipas thirrjes publike. Pra, a ka qenë thirrja për OJQ-të siç kanë qenë në statutin e tyre OJQ-të që nuk kanë përfitme ekonomike apo ka qenë thirrja edhe për OJQ-të biznesi që ushtrojnë veprimitari ekonomike. Duke u mbështetur në thirjen publike dhe në vendimin përfundimtar kërkojmë nga drejtori që të na tregon se a ka OJQ që ka përfituar dhe zhvillon aktivitete afariste, si dhe ju si drejtori a e kanë përbushur misionin e tyre? Kur dijet që fusha e sportit në Viti që është fusha e sportit, është në gjendje të mjerushme, për faqe të zezë. Nuk jemi kundër subvencionimit të sportit në komunën tonë. Jam njëri ndër ata që, kur ka qenë në pyetje me naj mbrojt dinjitetin Pozharani, kam kërkua me dyfishu në investim të klubit, mirëpo me përfitë dikun 51900 euro sport, dhe fushat me i pas në këtë gjendje si e kemi, me të vërtet është shqetësuese kjo. Fushat dojnë mirëmbajtje. Ne po ja japim paranë publike individit të caktuar, mirëpo ata individ a i shpenzojnë për interesat personale të klubit apo për fitime të fëmijëve të cilët prindërit i qojnë për me përfitë. Duhet me e ditë sakt për çka jemi tu i dhanë edhe për çka janë tu e shfrytëzu. 27 OJQ në komunën tonë! Asnjë nuk kemi besu që ekzistojnë, sepse në fushëveprimin e tyre nuk shifen nëse duken. Është mirë me i arsyetu.

z.nj.Zejnepe Osmani: Pëershendetje të nderuar të pranishëm! Drejtor, dua ta di dy OJQ, e para edhe e dyta në renditje: a janë të njëjtë pronar? Dua një sqarim.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Po pergjigjem nga pyetja e Ilirit, i cili tha që, ka pas OJQ që kanë përfitë edhe në komunat tjera kur është bë thirrja publike e Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport. Decitivisht në thirrje publike është shënuar që, OJQ duhet të jet nga Komuna e Vitisë dhe veprimitarinë ta zhvillon në Komunën e Vitisë. Për ta dëshmuar këtë, secila OJQ në regjistrin e regjistrimit të OJQ-ve në Ministrinë e Punëve të Brendshme i shënon edhe vendndodhja. Dhe unë të garantoj, edhe pse komisioni vlerësues e ka bë përgjedhjen, të garantoj që nuk ka OJQ që ka përfitë e që nuk vjen nga Komuna e Vitisë. Kurse, a kanë fitu në komuna tjera nuk e di, po unë gjithëhere i gëzohem fakti kur OJQ-të e viseve përfitojnë në komuna tjera, në ministri. Ajo është një pjesë tjetër që nuk na takon neve si drejtori. Tek numri 24 që thave, është i shprazt, janë edhe disa numra të tjerë, është organizata që ka apliku po nuk ka perfitë. Pyetja e Sejdi Eminit rrëth çështjes që e lidhi tek menagjeri i prokurimit, Fadil Abazi. Kam pas këtë pyetje edhe nga Kallzo.com. Person i autorizuar i shoqatës së shkrimtarëve, "Ramadan Musliu" dhe menaxher i projektit "Ramadan Musliu" është Muzafer Ramiqi. Po edhe në anën tjetër, vitin e kaluar e kemi pas një paqartësi rrëth zyrtarëve komunal që kanë pas OJQ dhe që kanë apliku. Ju kemi drejtu Agjensisë Kosovare Kundër Korruptionit. Kjo agjenci nuk na ka vendos kufizime për zyrtarët komunal që përfitojnë edhe subvencione për OJQ-të, kurse tek çështja e temës së fushave sportive është dikaster tjetër prej subvencioneve. Rrëth stadiumit të qytetit, e potencove. Unë edhe më herët kam thanë këtu që, është një store jo e mirë e qytetit të Vitisë. Ai stadium është promovu me 14 Qershor 2021. Me datën 12 janar 2022 e kam marr pozitën e drejtorit edhe nuk kam pranu me i marr qelsat e stadiumit të qytetit të Vitisë, edhe nuk do të pranoj kurrë, për shkak se aty po e thamë publikish ka dyshime dhe nuk janë kry punët mirë, edhe secili që ka shkel ligjin e që nuk i ka kry punët mirë, le ta mbajt përgjigjen e merituar konformë pozitës që e ka pas, se e di që kjo çështje edhe tek Kallzo.com është ngritë. Po sqarohem edhe para qytetarëve të Komunës së Vitisë, nuk kam pas ftesë me qenë pjesë e atij debati për shak se nuk i iku përgjegjësisë. Jemi neglizhu ne, sepse nuk kemi pas ftesë. E për mu rinia e Komunës së Vitisë është mbi adresat politike e mbi qëllimet politike përgjithmonë. Rrëth pyetjes së Zejnepes, në mes të OJQ-së "SkoffKosova" dhe OJQ-së "Kemajl Azizi". "SkoffKosova" është OJQ që ka për qëllim organizimin e festivaleve brenda territorit të Komunës së Vitisë. E ka një festival tashma të akredituar ndërkombëtarisht me person të autorizuar, Arsim Abazin, ndërsa OJQ "Kemajl Azizi" dijet, ansambli i qytetit të Vitisë per person të autorizuar Arlind Demiri dhe me përgjegjësi e tham që, ne aspektin ligjor të dy organizatat kanë persona të ndryshëm.

z.Ramadan Deliu: Pershendetje per të gjithë! Drejtori tha, nuk i kam pranu unë qelsat e stadiumit. Ku ke pa ti me e pranu postin e drejtorit, me e marr rrogën si drejtor, e fushën mos me e pranu? Edhe një pyetje drejtor e kam. Në emisionin kur i qita "Jeta Xharra", fushat tek shkolla e mesme, ti je drejtor: a ke bë ndonjë here kallëzim penal në polici për rastin, pse po prishet fusha? E kishin hek basketin. A interesohesh ti a po vetëm e merr rrogën edhe shkon tek shpija?

z.Bekim Azizi, kryesues: Ramadan, vetëm duhet me i nda. Si të hin në oborr të shkollës është e Drejtorisë së Arsimit. Drejtoria e Kluturës nuk ka të drejtë mu përzi aty hiq, sepse fusha është e shkollës e shkolla është me Drejtorinë e Arsimit.

z.Ilir Zuka: Drejtori vetëm një sqarim, a jan aktive krejt? Edhe të lidhem me Sejden. Gjatë kohës sa kemi marr subvencione, se deri këtë vit kam qenë pjesë e KF "Vllazia". Me krenari e kam mbaj postin e drejtorit e sekretarit për dhjetë vite. Unë po tham, Sejdi, ti thamë apo bajnë biznes apo po i marrin per veti ato pare. As 5% të shpenzimeve të një klubit nuk i mbulon subvencioni i drejtorisë. Pra, keq për njerëzit që janë tu dhanë mjete per me i mbajtë gjallë OJQ-të e klubet. Ne, një raport që e kemi ba kur e kemi dorëzu klubin, për 5 vite i kemi dorëzu raportin financiar nëpërmes bankës, që kanë pagu donatorët 379 mijë euro. Prej drejtorisë jemi falenderues.

z.Sejdi Emini: Unë e veqova klubin e Pozharanit si klub edhe thash kam bë thirrje me ja dyfishu. Po ka shkolla të futbollit që i marrin ndoshta edhe 10 mijë euro edhe prind duhet me pagu për çdo muaj aty nga 20 euro, e kur ti marrin qeto 10 mijë euro ata prind duhet me i liru për interes të përgjithshëm. Kjo ke mesazhi.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Reth këshilltarit Ramadan Deliu. Unë asnjëhere nuk e lëshoj gjuhen e debati në nivele personale, edhe këtë nuk do ta bëj kurrë. Me datën 12 janar e kam marrë pozitën e drejtorit, edhe në momentin kur e kam marr pozitën e drejtorit dijet gjendja e stadiumit të Vitisë, prandaj secili le ta mbaj përgjegjësinë brenda kompetencave që i ka, por zakonish nuk flas shumë për veten, po gjithmonë kam zgjedhur që për mu me fol puna, prandaj për DKRS-në flasin raportet nga organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, flet raporti i MAPL-së, ku DKRS-ja është viti i dytë radhazi që është drejtoria me e mirë në nivel të Kosovës, që besoj me këto të arritura do të jet krenar secili qytetar i Komunës së Vitisë, përfshirë edhe ty, për shkak se besoj që sukeset e Komunës së Vitisë janë sukese të të gjithë qytetarëve të komunës sonë, dhe nuk duhet të na ndajnë po të na bashkojnë se cilin prej neve. Tek Iliri rrëth funksionalizimit të OJQ-ve. Ilir, është viti i tretë ku DKRS-ja për herë të parë në Komunën e Vitisë pas ndarjes së subvencioneve të DKRS-së formon komisionin monitorues të këtyre projekteve, prandaj secila nga këto OJQ janë të obliguar që në fund të vitit tek komisioni i cili është komisioni profesional i pavarur t'i dërgojnë raportet e tyre narrative dhe financiare, edhe po ashtu dua ta theksoj edhe sot që, d.m.th viti i kaluar është për herë të parë kur një OJQ që nuk ka pru rapot për shpenzimet e parash publike është fut në sanksione dhe nuk ka përfitë subvencione në këtë vit.

z.Ramadan Deliu: Drejtor, ti thave që kur ke ardh e ke gjetë stadiumin keq. A duhet me ba diçka ti për mu ndreq apo me lanë qashtu. E kam gjet keq, me lan qashtu. U kanë dashtë me shku me pa ku janë parregullësitë e me ba veprime me u rregullu. Për qata je drejtor, që për me i rregullu.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Ramadan, unë vazhdimisht kam dërgu shkresa në Ministri të Kulturës, Rinisë dhe Sportit si organi me i lartë për restaurimin dhe renovimin e stadiumit, edhe stadiumit në Pozharan, por arsyetimi i tyre me të drejtë ka qenë që si me intervenu prapë me një stadium ku janë investu 400 mijë euro para një viti, e në atë stadium nuk është zhvillu asnjë ndeshje.

z.Musli Neziri: Meqenëse u diskutu debati që ka qenë tek Jeta Xharra, po aty e kemi pas kohën e limituar, aty. Të njëjtë pyetjen e ka bë këshilltarit Ramadan Deliu, ndërsa në krejt fjalimet e tona pyetjet kanë qenë për kryetarin. E Ramadani disi po mundohet ti atakon njerëzit pa përgjegjësi. Hyka edhe të pjesa e shkollave që nuk ka informatë fare, po vetëm hajt të flas diçka. Ti bëjë pyetje drejtorit të PDK-së, e drejtori u përgjigj shumë mirë. Tek pjesa e stadiumit edhe mu më pengon ajo pamje e stadiumit të qytetit, po të bëjmë këtu diçka që edhe Ramadani e din që, s'a përgjegjësi e atij drejtori, por Ramadan, tu kisha lutë që, mundësish kur ti adreson pyetjet, bile të kanë bazë se pastaj po flasim kot.

z.Ramadan Deliu: Musli, unë që je profesor e kam ditë, a që je avokat nuk e kam ditë. Demek unë nuk po bajka me i thanë drejtorit për fushë që është në qat gjendje.

z.Musli Neziri: Avokatin nuk e di a e kupton ti Ramadan, se në këtë rast vetëm ti pyetjet adresoj ku duhet e jo ku nuk duhet. Ama nuk qon peshë kjo për mu se si me vlerëson ti.

z.Ilir Zuka: Drejtori i kulturës naj bëni raportin shumë të detajuar, po nuk me pëlqej ajo që e tha drejtori kur thave që me vend e ka pas ministria. Se e din edhe kryesuesi që, në KPF e kemi hapë një kod të veçant për

tribunën e stadiumit Ibrahim Kurteshi, e arsyja e tyre ka qenë nuk po mundemi me ju qitë mjete se nuk kanë kod buxhetor, e ne kete e kemi hap kodin vitin e kaluar edhe ende ata nuk kanë ndërmarr asgjë, e ne e kemi bë me mjete vetanake si Pozharan.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Tek stadiumi në Pozharan. E para unë nuk u referova stadiumit “Ibrahim Kurteshi”, e për këtë stadium saktësish janë 14 kërkesa të drejtuar nga ana ime drejt Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Është një stadium që e meriton me pas tribuna, për shkak se KF “Vllaznia” është krenaria e Komunës së Vitisë. Nga bisedat e fundit me këshillaren e ministrit, Gentijana Pallaska, është zotua që mu formu një komision në mes të Ministrisë së Kluturës dhe FFK-së, si pasoj e një marrëveshje të një momerandumi, të një plani 5-vjeçar per rivitalizimin e stadiumeve të futbollit të Kosovës. Është zotu edhe nga kryetari i komisionit, Florim Kryeziu, ka marr zotime që edhe stadiumi i “Vllaznisë” së Pozharanit do të jet prioritet për vitin e ardhshëm.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

5. Informatë nga DKA-ja mbi fillimin e viti të ri shkollor

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë: Përvendetje të nderuar të pranishëm! Më lejoni ta paraqes informatën nga DKA-ja mbi fillimin e viti të ri shkollor. Viti shkollor 2023-2024 në të gjitha shkollat ka përfunduar me kalendarin e viti shkollor në arsimin parauniversitar, ku i kemi të cekur në informatën të cilën e keni marr ju me kohë. Nuk po ju hupi kohë tani, po për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

z.Bekim Azizi, kryesues: A ke naj përgjigje për pyetjen e Ramadanit përfunduar në shkolla.

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë: Ramadan, edhe pse u diskutu puna e fushës tek shkolla e mesme e ku është duke punu. Fakt që është dëmtu prej bartjes së materialit, sepse shkolla është në renovim. Ata që e kanë dëmtu fushën do të përgjigjen. E kemi lanë deri sa të përfundon renovimi i objektit.

z.Ramadan Deliu: Fusha u pa që u dëmtu po basketi qe e kishin shkoq mrezhen e volejbollit me thirrë policinë me e hetu rastin.

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë: Deri sa objekti është në mbikëqyrje, sepse është tu investu Bashkimi Evropian. E kamera nuk kemi aty, e rastet normal i marrin organet kompetente. Në ato shkollat ku i kemi kamerat thuaja se në shumicën e shkollave i kemi aty, e kemi me të lehtë edhe të gjendet shkaktari i dëmtimeve.

z.Taulant Haxhiu: Drejtoreshë, deshta me e ditë numrin e nxënësve total në krasim me vitin e kaluar. A ki naj informatë, sa kemi ramje në numër të nxënësve në Komunën e Vitisë? Edhe tek çerdha që e kemi tek “Gëzimi Ynë”: a është rritë numri apo zvogëluar?

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë: Vitin e kaluar i kemi pas rrëth 7 mijë nxënës, ndërsa këtë vit i kemi 6522 nxënës. Edhe pse nuk është ky numër i saktë, prapë po thamë se, unë e kam dorëzu informatën dy javë përpëra, para se me përfundu sistemi, smija që eshte prej qendres. Sa i përket çerdhes, i kemi, po e thojke tek te dy çerdhet, në Qifllak edhe këtu në Viti i kemi 183 fëmijë të regjistruar. Është e mbingarkuar. Në Qifllak janë rrëth 60 fëmijë.

z.Nexhat Halili: Te klasa 12, ka përfunduar mësimin më 16.05.2024. Sa është numri i nxënësve që e kanë përfundu.

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë: Vitin e kaluar i kemi pas që e kanë kalu testin 282 nxënës maturat që e kanë kalu testin.

z.Zejnepe Osmani: Drejtorshë, unë kisha kërku një informatë për hapjen e çerdhes në Drobesh. Kur do të fillon?

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë: Në fshatin Drobesh çerdhja thuajase është në finalizim, edhe pse unë e kam formu, edhe komisioni siç është kërku nga ministria. Mirëpo në këtë javë prapë ma kanë kërku komisionin e kam formu prapë. E kam dorëzu, ka kërku edhe paramasën. Kam bë gati e kam dorëzu, më është rikthy, do të punoj prapë në paramasë, e kam cek edhe më herët në kuvend, punëtorët që i kemi kërku për hapjen e çerdhes në Drobesh më janë leju vetëm me qarkoren e dytë buxhetore, kështu që, qarkorja e dytë buxhetore fillon nga janari e tutje.

z.Ilir Zukë: Drejtoreshë, e dimë interesimin për shkollën në Pozharan, edhe u flitë që në tetor ka mu lëshu, edhe u rrit numri i nxënësve. I kanë pru nga fshatra tjerë se po bëhet një objek i mirë shkollar. Tash jemi në nëntor kur pritet mu kry shkolla në Pozharan. A ki informata a ka naj datë të sakt.

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë: Ilir, sa ki informata ti për shkollën në Pozharan kemi edhe ne si DKA. Na shkojmë i vizitojmë vazhdimisht. Informatën e kam, nuk e di arsyen pse është hap një ankesë në tender për lyerjen dhe disa intervenime të vogla. Kështu që, pa u kry edhe ai aneks tenderi, unë nuk e besoj që do t'i kthejnë nxënësat në objek shkollar. Kështu që nuk muj me të thanë që kam informatë se kur do të përfundojnë punimet aty.

z.Taulan Haxhiu: Po du me ditë a me shumë kemi 2022-2023, dallimin, a më 2023-2024, për shkak se liberalizimi i vizave. Po du me ditë a janë nxanësat më shumë në këtë krahasim 2022-2023 apo 2023-2024. Është mirë me ditë edhe opinionin, se ky liberalizimi i vizave a e ka ulë numrin e nxënësve apo është njëjtë.

znj.Arta Ajeti, drejtoreshë: Po kjo është shumë shqetësuese, se nga viti 2021 kemi thuajse çdo vit ramje të numrit të nxënësve.

z.Bekim Azizi, kryesus: Faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë. Shihemi në seancat e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:00 min.

Procesmbajtësi:

Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:

Bekim Azizi



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Pronar/Prompeno Me Data: <u>12-11-2024</u>			
Nr. Llojarit	Nr. e Prgj.	Shtypja e Dëshmorit	Vlera Vjetore
02-	095/02-		1277

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 shkronja h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 9 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2, e datës 15 Shkurt 2018), nenin 50, shkronja i të miratit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kryetari i komunës së Vitisë më datë 11.11.2024 i propozon për

PROPOZIOM V E N D I M

për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025

Neni 1

Norma Tatimore

Me këtë propozim vendim Kryetari i komunes së Vitisë i propozon Kuvendit të komunës së Vitisë që të miraton vendimin për caktimin e normave tatimore për vitin 2025 për të gjitha kategoritë e pronave në tërë Komunën e Vitisë, me përjashtim të kategorisë pronë publike dhe përjashtimeve tjera sipas legjislativit përkatës, më sa vijon:

Normat tatimore sipas këtij nenit caktohen konform Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri në 1.9 dhe Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, pika 1 si dhe pikat 1.1 për njësitë bujqësore të parcelave, 1.2 për njësitë bujqësore të objekteve, 1.3 për njësitë pyjore të parcelave, 1.4 për njësitë rezidenciale të parcelave, 1.5 për njësitë rezidenciale të objekteve, 1.8 për njësitë industriale të parcelave dhe 1.9 për njësitë industriale të objekteve, Kuvendi i Komunës së Vitisë cakton normat tatimore për vitin 2025 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronave publike, me sa vijon:

- | | |
|--|-------|
| 1.1 Për njësitë bujqësore të parcelave----- | 0.15% |
| 1.2 Për njësitë bujqësore të objekteve----- | 0.15% |
| 1.3 Për njësitë e pyjore të parcelave----- | 0.15% |
| 1.4 Për njësitë rezidenciale të parcelave----- | 0.15% |
| 1.5 Për njësitë rezidenciale të objekteve----- | 0.15% |
| 1.6 Për njësitë komerciale të parcelave----- | 0.17% |
| 1.7 Për njësitë komerciale të objekteve----- | 0.17% |
| 1.8 Për njësitë industriale të parcelave----- | 0.15% |
| 1.9 Për njësitë industriale të objekteve----- | 0.15% |

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – Sektori i Tatimit në Pronë.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë,





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITINA



Pranuar / Pranëmëri me Data: 13-11-2024			
Nr. I Tregimit Ora/ Bora	Numeri i Tregit	Shtypja e Tregut	Vlera Vrednost
02	033/02	1285	

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 031-40, të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28, qershor 2008) dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me neni 14, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) neni 5 paragrafi 1 pika 1.3 neni 6 dhe 13 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjes në Shfrytëzim dhe Kembimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja I), të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës me datën 13.11.2024, bën këtë :

PROPOZIM VENDIM

Paraprak për dhënjen në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim paraprak, propozohet të **jepet pëlqimi** për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshëme të Komunës së Vitisë , në shfrytëzim afatgjatë pësonave fizik dhe juridik deri në 20 vite , për ushtrimin e veprimtarisë biznesore , respektivisht vendosjen e paneleve solare përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 2.

Prona e palujtëshme për dhënjen në shfrytëzim , sipas nenit 1 të këtij propozim –vendimi janë:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00197, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zhabelj , me kulturë Kullosë e klasit të 6 , me sipërfaqe prej 96342 m², e evidentuar sipas çertifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.
2. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00200-0, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zabel , me kulturë Kullosë e klasit të 6 , me sipërfaqe prej 130577 m², e evidentuar sipas çertifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Çmimi fillestari i pronave të palujtshëme komunale të cekura në ninen 2 , pika 1 dhe 2 të këtij propozim-vendimi do ta përcaktoj komisioni vlerësuar i ofertave për dhënjen e pronës së palujtshëme të Komunës në shfrytëzim afati gjatë.

Neni 4.

Qellimi i dhenjes në shfrytëzim të pronës komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale .

Neni 5.

Procedurat për dhënjen e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatgjat realizohet përmes shprehjes së inereit, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Kembim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjes në Shfrytëzim dhe Kembimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës.

Neni 7.

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës , Zyra Administratës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjent dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

Neni 8.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës
Sokol Haliti





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Devajë

Njësie/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70101018-00197-0	Parcelë / Parcela / Parcel	96342
P-70101018-00200-0	Parcelë / Parcela / Parcel	130577



Shkalla/Razmerra/Scale: 1:7535



Punoi/Obradio/Created: Kushtrim Imeri

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Data/ Data/Date: 13.11.2024

Koha/ Vreme/ Time: 10:24:09



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republik of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Vitisë

Nrumi i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	1595/2024
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	13.11.2024 - 09:16
Komuna / Opština / Municipality:	VITI / VITINA / VITI
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Last Name / Business Name	Emri First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/biznesit Lëoni broj/broj postolovanja ID. No.	Shiteti i shtetësisë apo regjistrimit/Država državljanstva ili ukuqijenja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Birth/Establishmen t	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
Komuna e Vitisë	/	/	/	600424486	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO		29.12.2020	

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojedininosti adrese Address Details	Adresa tjeter Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
/		28 NËNTORI	REPUBLIKA KOSOVA NA VITINA DHE GJELQI GEODEZI	



B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT



Nr. e regjistrimit / Registration number	Viti / Year	Kod kadastral / Cadastral code	Kod komuna / Municipality	Kod zonës kadastrale / Cadastral zone	Zona kadastrale / Kadastral zone	Tipi i pronës / Property Type	Kati / Katet Br.Sprat al	Sipërfaqja / Surface Area	Shifre tezimi aktual / Actual klaša / Kultura-klaša upotreba / Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine / Share quota	Lloji i së drejtës / Type of the right	
P-70101018-002000-0	2019 - 0	VITINA / VITI	Devajë / Devajë / Devajë	PARCELI / PARCELA / parcel	Prone shqiptore Drashiveva Inovina Socially owned Land /	ZHABELI / ZHABELLI / ZHABELJ	96342	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klašës 6 / / Poljoprivredno - Pasnjaci - Pasnjak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class pasture / / Pasture / /	Kullosat - Kullosë E Klašës 6 / / Poljoprivredno - Pasnjaci - Pasnjak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class pasture / / Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dravina / Single possessor	Lloji i së drejtës / Type of the right
P-70101018-002000-0	2019 - 0	VITINA / VITI	Devajë / Devajë / Devajë	PARCELI / PARCELA / parcel	Prone shoqërore Drashiveva Inovina Socially owned Land /	ZABEL / ZABEL / ZABEL	130577	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klašës 6 / / Poljoprivredno - Pasnjaci - Pasnjak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class pasture / / Pasture / /	Kullosat - Kullosë E Klašës 6 / / Poljoprivredno - Pasnjaci - Pasnjak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class pasture / / Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dravina / Single possessor	Lloji i së drejtës / Type of the right



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITINA - OPŠTINA VITINA



Pranuar - Prinjeno Me Datan			
Nr. Formular	Numri Broq.	Shtoqec	Vlera vjetore
02	035	02	1284

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjn lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008, nenit 17 pika 2 lidhur me piken 6 të Ligjit për dhënjen e pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim nr.06/L-092, neni 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe këmbim e pronës së palujtshme të komunës dhe neni 10 paragrafi 2 pika i lidhur me nenin 50 pika 1, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë me datën 13.11.2024 bënë këtë :

PROPOZIM VENDIM

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim , propozohet të formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurrimit të hapur për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës në shfrytëzim afat gjatë deri 20 vite (njëzet vite) për njësia kadastrale me nr. P-70101018-00197, në zonën kadastrale në Devajë, me sipërfaqe prej 96342 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë dhe njësia kadastrale me nr. P-70101018-00200-0, në zonën kadastrale në Devajë, me sipërfaqe prej 130577 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Propozohet që komisioni sipas pikës 1 të këtij propozim- vendimi përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve si në vijim:

- Shefki Aliu- anëtar i komisionit-Përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës.
- Mustafë Islami - anëtar i komisionit – Përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës
-- Përfaqësues i Kuvendit të Komunës
-- Përfaqësues i Kuvendit të Komunës
-- Përfaqësues i Sektorit jo qeveritar.

Neni 2.

Me këtë propozim- vendim , detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për dhënjen në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës me nr.10, të datës 03.04.2019).

Komisioni vlerësus udhëheq me procedurat mbi dhënjen e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim si : shpallja e njoftimit publik për shprehjen e interesit , përcakton çmimin fillestar , vlerëson ofertat dhe ja propozon kuvendit ofertën ma të favorohme, si dhe informacione shtesë.

Neni 3

Kuvendi i Komunës së Vitisë e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënjes në shfrytëzim afatgjat të pronës së palujtshme të komunës ti zhvilloj proceurat e konkurrimit të hapur dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesesen anëtaret e komisionit dhe Zyra e Prokurimit në komunën e Vitisë.

Neni 6.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA

DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI



Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale me nr. 03/L-40 dhe neni 24 të Ligjit Nr..06/L-092 për dhënjen në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme Komunale,neni 29 paragrafi 5 i Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të Komunës dhe nenit 50 pika l, e Statutit të komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kryetari i Komunës së Vitisë përmes Drejtorisë për Kadaster Pronë dhe Gjeodezi i Komunës së Vitisë - Opština Vitina, me datën 14.11.2024, propozon këtë :

REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prunjeno Me Data: 15-11-2024			
Nr. Logjistik Org. Bro.	Pranuesi/Prez.	Shtypja e Dyshimit	Vlera Vrednost
02-035/02-	1292		

PROPOZIM – VENDIM PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHME PUBLIK.

I.

Me këtë propozim vendim , propozohet të bëhet shpallja zonë me interes të përgjithshëm publik për palujtshmerinë, pronën private që evidentohen në emër të Sali (Bajram) Musliu për pjesën e parcelës kadastrale në sipërfaqe prej 52m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 297m² në ngastrën kadastrale me nr.3108. në vendin e quajtar “ Fshat Oborr ” në zonën kadastrale në Viti, për arritjen e qellimit të ligjshëme publik për nevojat e banorëve të qytetit të Vitisë.

II.

Pas marrjes së këtij Propozim-Vendimit për shpalljen e pronës private si Interes i Ligjshëm Publik, Kryetari i Komunës do të inicojë procedurat e metutjeshme për kembimin e pronës private me atë publike për arritjen e qellimit të lartcekur duke zbatuar Ligjit për dhënjen në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme Komunale dhe Rregulloren për caktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim dhe kembim të pronës së palujtshme të Komunës.

III.

Për zbatimin e këtij propozim - vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës , Drejtoria për Urbanizem, Planifikim dhe Mbrojtjen të Mjedisit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente dhe Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi.

IV.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure /

AGJENCIJA KADASTRALE E KOSOVËS / KADASTRAL AGENCY / KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101007-03108-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	1611/2024
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	20.11.2024 - 08:55
Komuna / Opština / Municipality:	VITI / VITINA / VITI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Viti / Vitina / Viti
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R GIS U/R	Spërthaqja Površina Area (m ²)	Përshtkim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Krijuar më datën Ažurruar Ažurruano Updated Created On
P-70101007-03108-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Prone private / Privatna Imovina (Privately owned Land	Urban	297	001-2004		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Postanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurruano Updated Created On
FSHAT OBORR				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCIENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parceles Vrsta koriscentje parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscentje parcele Parcel Current Use		Kualiteti i klasës Qualitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
		Shëpi-Ndërtese/Kuca-Z-grada/Building	Obor/Dvorishtë/BackYard		
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemjësi/Construction land				239
2	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemjësi/Construction land				58

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lieni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinstë adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovinë Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
	MUSLIU SALI (BAJRAM)	1500152611	VITI / VITINA / VITI /			1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA

DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI



Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale me nr. 03/L-40 dhe nenit 50 pika I, e Statutit të komunës së Vitisë, Kryetari i Komunës së Vitisë, neni 4 paragrafi 1 pika 1.1 dhe paragrafi 2 pika 2.3 të Ligjit për Shpronsimin e Pronës së paljtshme (Ligji nr.03/L-139) Ligji Nr.03/L-205 REPUBLIKA KOSOVA dëshmi i Drejtoria PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI dëshmi i KOMUNA E VITISE / OPSTINA VITINA përmes Drejtorisë për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi në komunën e Vitisë me daten 14.11.2024 propozon këtë :

Pranuar - Prandajte	data	20-11-2024
Nr. I organizat	Vlera	Vrednost
Org. Broj		
02	035/02-	114

PROPOZIM – VENDIM

PËR SHPALLJEN INTERES TE PERGJITHSHEM NGASTRËN KADASTRALE NË ZONËN KADASTRALE NË VËRBAN

I.

Me këtë propozim vendim, propozohet të behet shpallja zonë me interes të përgjithshëm ngastra kadastrale me :

Pjesa e ngastres kadastrale me sipërfaqe prej 12000m² në numër të ngastrës P-70101008-00491-0, me sipërfaqe prej 26275m² në vendin e quajtur " Jarinski Breg Beli Dub" në zonën kadastrale në Vërban, në pronësi të D.S.S O. VITINA POLJOPRIVREDNO DO.BELI D.

II.

Ngastra kadastrale e shpallur zonë me ineteres të përgjithshem si në pikën 1 të këtij propozim – vendimi në zonën kadastrale në Vërban bazohet në kërkesën e Kryetarit të Këshillit fshatit Vërban me nr.01-320/04-34889 e datës 19.09.2024 që do të shfrytëzohen për varrezat e fshatit Vërban me qellim të interesit përgjithshëm publik, për interes të qytetarëve të komunës së Vitisë.

Me kete propozim vendim anulohet propozim vendimi me nr.02-035/02-1297 i dates 19.11.2024.

III.

Për zbatimin e këtij propozim - vendimi do të kujdeset zyra e Kryetari të Komunës së Vitisë, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Financa e Komunën së Vitisë.

IV.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republie of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapešinor dhe Infrastruktures / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure /

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101008-00491-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	1611/2024
Data që koha e tëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	20.11.2024 - 08:56
Komuna / Opština / Municipality:	VITI / VITINA / VITI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Vërban / Vërban / Vërban
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR NJËSISË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona UJR GIS UJR	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshtkim Opis Description	Krijuar më datën Uradfjeno na dan Created On	Krijuar më datën Azhvuruar Ažurirano Updated
P-70101008-00491-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shtoqësore / Drushtivena / Imovina / Socially owned Land		26275			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rruges Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradfjeno na dan Created On	Azhvuruar Ažurirano Updated
JAIRSKI BREG BELI DUB				

A.2 LLOJI I SHFRTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcerës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriseneje parcele Parcel Current Use		Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
		Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 7/Njiva 7 Klase/7th Class Arable Land		
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture				26275

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAČ - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Pošanski kod Postal code	Hollësi e adresës Pojedinitost adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Državina / Single possessor	D S S.O.VITINA POLJOPRIVREDNO DO.BEL.I.D.	KCID0103401	VĚRBAN / VRBAN / VĚRBAN /	VITINA	1/1			



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Primitivo Me Dana 12-11-2024			
Nr. Organit	Nr. Broj	Shtatorë Person	Vlerë Vredoste
Otg. Broj			
	021 035/02 - 1129		

Republika e Kosovës
 Republika Kosova/Republic of Kosovo
 Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti

Duke u mbështetur në nenin **58**, pika h të Ligjit mbi qeverisjen Lokale Nr.03/L-040; nenit 50, pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë, nr.01-013/491, datë 21.04.2011; të nenit 14 paragrafi 1 dhe paragrafi 8.1 të Rregullores (qrk) nr.19/2024 për procedurat e përgjedhjes dhe emërimit të drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, si dhe duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë që ka, Kryetari i komunës së Vitisë më datë 11.11.2024 i propozon për miratim Kuvendit të Komunës së Vitisë këtë:

PROPOZIM VENDIM

për miratim të dy anëtarëve të komisionit për vlerësimin dhe përgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve për institucionet edukativo arsimore të nivelit, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunën e Vitisë

- I. Përmes këtij propozim vendimi kërkohet nga Kuvendi Komunal i Vitisë të miratohen dy anëtarët e propozuar për komisionin për vlerësimin dhe përgjedhjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve për institucionet edukativo arsimore të nivelit, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunën e Vitisë.
- II. Anëtarët e komisionit të propozuar nga DKA për miratim nga Kuvendi Komunal ka këtë përbërje:
 1. Zijadin Ahmeti, kryetar i komisionit, zyrtar i DKA-së
 2. Vjollca Zejnullahu, Drejtore e sh.f.m.u. "Skender Emërrahu", Ramjan
- III. Përmes këtij propozimi vendim konfirmojmë se personat (nr. rendor 1 dhe 2) e shënuar më lartë përmbushim kriteret të jenë anëtarë të Komisionit, sipas Rregullores 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.
- IV. Periudha kohore e mandatit të anëtarëve të lartëcekur do të jetë një vjeçare, nga momenti i miratimi të këtij propozim vendimi.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti.

Propozim Vendimi u dorëzohet:

- Kuvendit të Komunës së Vitisë
- Zyrës së Kryetarit
- DKA-së, Arkivit,

v.v

Kryetari i Komunës

Sokol HALITI





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA

Prijava - Prilikom Mijenjanja
Nomeratovanja
Opštine
Vrednost

12-11-2024			
02	025	02	1280



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

**PROPOZIM RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA, ME NR. 01-110/05-1151, E DATËS.30.09.2024**

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, pika h të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 9 dhe 13 të ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, kërkesën me Nr. 3826/2 e datës 08.11.2024 nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe nenit 50 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

**PROPOZIM RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES
PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA, ME NR. 01-110/05-1151, E DATËS.30.09.2024**

Neni 1

Me këtë propozim rregullore kemi për qellim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale me Nr. 01-110/05-1151, e datës 30.09.2024.

Neni 2

Te rregulloja baze neni 11 pika 11.3 shtohet edhe një nën paragraf 11.4 si ne vijim:

- a) Dru zjarri për m^31,50€
- b) Dru zjarri mbi $7m^3$2,00€
- c) Dru teknik m^3 3.00€

Neni 3

Te rregullorja bazë, neni 24 ndryshohet dhe i njëjtë riformulohet për arsyje të ndryshimit të bazës ligjore si në vijim:

Neni 24, të hyrat nga bashke pagesat për shërbime shëndetësore janë të hyra të cilat realizohen në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr 03/2024, bashkë pagesat për shërbimet shëndetësore, sipas shtojcës 1 dhe shtojcës 2.

Neni 4

Te rregullorja baze neni 28 pika 28.2 ndryshohet dhe plotësohet si: Tarifa e takses administrative për leje ndërtimore, kategoria I-rë një euro e pesëdhjetë cent (1,50 euro) për metër katror.

Ndryshohet dhe duhet të jetë:

Tarifa e takses administrative për leje ndërtimore, kategoria I-rë duhet të jetë dy euro (2, 00 euro) për metër katror.

Neni 5

Pjesët tjera të rregullores bazë mbisin të pandryshuara.

Neni 6

Kjo propozim rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Vitisë dhe certifikimi ligjor nga MAPL dhe MEF.

Propozues: Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Haliti





Republika e Kosovës

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
Nr. 10
Datë: 12.11.2024
VITI

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Prandar Prandar, f.M., Data: 12-11-2024

Nr. / Çorterat	Pylltari / Tregat	Sip. e planif.	Vlera
01-01-01-01	01-01-01-01	01-01-01-01	281

Komuna e Vitisë

Informatë përmblidjet vjeshtore

PLANI
Operativ përmblidjet vjeshtore për vitin 2024 – 2025

Ky vit ka qenë veçanërisht i favorshëm përmblidjet vjeshtore, falë kushteve të mira atmosferike që kanë lehtësuar procesin e mbijelljes dhe rritjen e sipërfaqeve të kultivuara. Subvencionet e ofruara kanë shërbyer si një motiv i rënësishëm përmblidjet vjeshtore, duke nxitur një interes më të madh në kultivim, edhe pse kjo kulturë mbillet kryesisht përmblidjet vjeshtore.

Nr.	SEKTORI	KULTURA	Sip. e planif. përmblidjet vjeshtore	Rendime nti i planifik. përmblidjet vjeshtore	Sasia e farës përmblidjet vjeshtore	Sasia e pluhut përmblidjet vjeshtore	Gjithësej sasia e farës në ton	Gjithësej sasia e farës në ton	Sasia e NPK dhe NAG 50%-50%	Lëndë djegëse përmblidjet vjeshtore	Gjithësej Lëndë djegëse në L.
1	INDIVIDUA L	GRURË	3524.82	5000 kg	300 kg	350 kg	1057,446/ ton	1233,687/ ton	40 L	40 L	140,992,8 L
2	INDIVIDUA L	ELBË BIRRE	3.94	3000 kg	200 kg	300 kg	788/kg	1,182/kg	40 L	40 L	157,6 L
3	INDIVIDUA L	THEKËR	3.52	2500 kg	250 kg	300 kg	880 /kg	1056/kg	40 L	40 L	140,8 L
4	INDIVIDUA L	BIMË FORAXHERE	28	4000kg	50 kg	300 kg	1400/kg	8400/kg	40 L	40 L	1,120 L
5	INDIVIDUA L	TËRSHËRE	9.70	2500 kg	200 kg	200 kg	1940/kg	1940/kg	40 L	388 L	
		GJITHSEJ	3,569,98/ ha								144,217,6/L

12.11.2024

VITI

Drejtori i Bujqësisë

Naim Pira

